



DEKLARATA E PRIVATËSISË E BIG GREEN EGG

Versioni i datës 29 gusht 2018

HYRJE

Kjo deklaratë e privatësisë lidhet me të gjitha të dhënat personale të klientit të mbledhura dhe / ose të përdorura nga Big Green Egg Europe B.V., e vendosur në De Lier (2678 MH) në Leemolen 80 (këtu e tutje referuar si: "BGEE"), p.sh. kur vizitoni faqen tonë të internetit www.biggreenegg.eu dhe faqet e mediave shoqërore, kur plotësoni formularin e kontaktit në faqen tonë të internetit, kur regjistroheni për fletushkën ose komunitetin tonë, ose kur regjistroni EGG tuaj, etj.

Në këtë deklaratë të privatësisë, ne shpjegojmë se si përpunojmë të dhënat tuaja personale dhe cilat janë të drejtat tuaja, ndër të tjera.

Ky dokument përmban informacionin e mëposhtëm:

1. Pse mbledhim dhe përdorim të dhënat tuaja personale?
2. Cilat të dhëna personale mbledhim dhe përdorim?
3. Si i mbledhim të dhënat tuaja personale?
4. Me kënd i ndajmë të dhënat tuaja personale?
5. Si i sigurojmë të dhënat tuaja personale?
6. Cilat janë të drejtat tuaja?
7. Ndryshimet
8. Kontakti

1. Pse mbledhim dhe përdorim të dhënat tuaja personale?

Ne ju kërkojmë të ndani të dhënat tuaja personale me ne për qëllimet e mëposhtme, ndër të tjera:

- mbajtjen e kontakteve me klientët tanë, duke përfshirë përgjigjen ndaj pyetjeve dhe kërkesave tuaja;
- regjistrimin e EGG tuaj;
- t'ju japë informacion rreth BGEE dhe produkteve të saj;
- t'ju mundësojë të merrni pjesë në komunitetin tonë online dhe të vizitoni kanalet tona / faqet në mediat shoqërore;
- ruajtjen e preferencave tuaja për çdo ndërveprim të ardhshëm me dhe komunikimin nga BGEE;
- dërgimi i mesazheve personale që lidhen me interesat tuaja personale, bazuar në informacionin që keni ndarë me ne dhe informacionin që kemi grumbulluar përmes përdorimit të faqes sonë të internetit dhe medias shoqërore nëpërmjet *cookies* ose teknologjive të ngjashme.

Nëse jeni tregtar, do t'ju kërkojmë të na jepni të dhëna personale për qëllimet e mëposhtme, ndër të tjera:



- shfaqjen e detajeve tuaja në faqen tonë të internetit;
- lehtësimin e marrëdhënieve me klientët dhe kontaktet me klientët;
- përmirësimin e komunikimit;
- përgjigjet në pyetjet dhe /ose kërkesat, si dhe ofrimi i informacionit mbi BGEE dhe produktet e saj;

Ne, në përgjithësi, do të përpunojmë vetëm të dhënat tuaja personale për qëllimet e renditura këtu. Nëse i përdorim të dhënat tuaja për qëllime tjera (të lidhura ngushtë), ne do të ndërmarrim masa shtesë të mbrojtjes së të dhënave kur kërkohet me ligj.

2. Cilat të dhëna personale mbledhim dhe përdorim?

Gjatë ndërveprimeve tuaja me BGEE, p.sh. kur të plotësoni formularin e kontaktit në faqen tonë të internetit, kur regjistroheni për fletushkën tonë, kur regjistroni EGG tuaj ose kur vizitoni faqet tona të medias shoqërore (në Facebook, për shembull), ne mund t'ju kërkojmë detaje të veçanta ose t'i mbledhim këto, siç janë:

- emri dhe mbiemri juaj;
- kompania juaj;
- gjinia juaj;
- adresa juaj;
- e-mail adresa e juaj;
- modeli EGG i juaj;
- gjuha juaj e preferuar;
- emrin dhe adresën e dyqanit / tregtarit ku keni blerë produktin (tet) tuaj dhe datën e blerjes;
- emrin, adresën, faqen e internetit, adresën e e-mailit dhe numrin e telefonit të pikës tuaj të shitjes;
- interesat tuaja;
- informacion mbi përdorimin e EGG tuaj;
- informacione të tjera në lidhje me aktivitetet tuaja online;
- nëse dëshironi të pranoni fletushkën dhe nëse jeni dakord me termat dhe kushtet e garancisë së BGEE

Në varësi të preferencave që keni vendosur në faqet e ndryshme të mediave shoqërore, të dhëna të caktuara personale mund të ndahen me BGEE; në lidhje me aktivitetet tuaja online, për shembull, dhe profilet tuaja të mediave shoqërore (siç janë: interesat tuaja, gjendja civile, gjinia, emri i përdoruesit, fotografia, komentet që keni postuar etj.).

Përveç kësaj, ne mund të mbledhim të dhënat tuaja personale nëpërmjet *cookies* ose teknologjive të ngjashme (shih gjithashtu më poshtë).

3. Si i mbledhim të dhënat tuaja personale?



Formulari i Kontaktit

Ne do të donim t'ju mundësojmë të na kontaktoni për të bërë pyetje dhe /ose për të bërë komente. Ky kontakt është i mundur nëpërmjet formularit të kontaktit në faqen tonë të internetit. Për t'ju përgjigjur në mënyrë të përshtatshme pyetjeve dhe /ose komenteve tuaja, ne do t'ju kërkojmë disa detaje personale nëpërmjet formularit të kontaktit. Nëse nuk i shkruani këto të dhëna personale në formularin e kontaktit, ne nuk mund t'ju përgjigjemi pyetjeve dhe /ose komenteve tuaja.

Fletushka

Ne do të donim t'ju mbajmë të informuar për lajme, ngjarje argëtimi, fushata dhe produkte të reja. Ne e bëjmë këtë nëpërmjet fletushkës Big Green Egg. Ju mund të abonoheni për fletushkën tonë nëpërmjet faqes sonë të internetit. Për të qenë në gjendje t'ju dërgojmë fletushkën tonë, ju kërkojmë që të ofroni të dhëna të caktuara personale. Nëse ju nuk i ofroni këto të dhëna personale, ne nuk mund t'ju dërgojmë fletushkën tonë.

Regjistrimi i produktit

Nëse dëshironi të përdorni garancinë e BGEE, ju duhet të regjistroni EGG tuaj. Ju mund ta bëni këtë nëpërmjet formularit të regjistrimit të produktit në faqen tonë të internetit. Për të zbatuar garancinë në mënyrë korrekte dhe që të mund t'ju kontaktojmë për ta diskutuar atë, ne kërkojmë që ju të jepni të dhëna të caktuara personale kur plotësoni formularin e regjistrimit të produktit. Nëse nuk i futni këto të dhëna personale, ju nuk do të mund të përfitoni nga garancia e BGEE.

Regjistrimi për komunitetin online

Ne do të donim t'ju njoftojmë me përdoruesit e tjerë të produkteve tona dhe t'ju informojmë për lajmet e fundit, opsionet e kuzhinës dhe këshilla për të bërë më shumë gjëra me EGG tuaj se sa keni menduar që është e mundur. Për këtë arsye, ne dëshirojmë t'ju ofrojmë mundësinë që të regjistroheni për komunitetin tonë të Big Green Egg. Ju mund të regjistroheni për komunitetin nëpërmjet faqes sonë të internetit. Si pjesë e procesit të regjistrimit, ne kërkojmë që të futni të dhëna të caktuara personale. Nëse nuk i futni këto të dhëna personale, ju nuk do të mund të merrni pjesë në komunitetin online Big Green Egg.

Media shoqërore

Ne i ofrojmë grupit tonë të synuar përmbajtje interesante nëpërmjet mediave shoqërore, duke u mundësuar atyre që të mbeten të përfshirë me kompaninë tonë dhe produktet tona. Kur i vizitoni këto faqe të mediave shoqërore, duhet të jeni të njoftuar me burimet që këto faqe ofrojnë për të vendosur preferencat tuaja kur është fjala për ndarjen e detajeve tuaja personale nëpërmjet profileve tuaja të mediave shoqërore. Ne jemi të detyruar nga politikat e privatësisë të mbajtura nga faqet e mediave shoqërore. Në varësi të preferencave që keni vendosur në faqet tuaja të mediave shoqërore, mund të ndodhë që disa informacione personale do të ndahen ndërmjet faqeve të mediave shoqërore dhe BGEE.

Cookies

Më shumë informacion mbi cookies



BGEE përpiqet që të bëjë përvojën tuaj online si dhe ndërveprimin e juaj me faqet tona sa më informative dhe relevante që është e mundur. Për të arritur këtë, ne përdorim *cookies* ose teknologji të ngjashme. Ne mendojmë se është e rëndësishme që ju të dini se cilat *cookie* përdor faqja jonë e internetit dhe për çfarë qëllime. Nga njëra anë, kjo do të kontribuojë në mbrojtjen e privatësisë tuaj, ndërsa nga ana tjetër do të sigurojë që faqja jonë e internetit të jetë sa më e lehtë për t'u përdorur.

Çfarë janë cookies?

Cookies janë dosje/fajla të vegjël me tekst që ruhen në pajisjen tuaj fundore (dmth. një kompjuter ose pajisje mobile) kur vizitoni faqe interneti të caktuara. BGEE mund të përdorë teknologji të ngjashme, siç janë pikselët, *ëeb beacons*, etj.

Për qëllim të konsistencës, të gjitha këto teknologji do të referohen më poshtë si 'cookies'.

Pse përdoren cookies?

Cookies mund të përdoren për qëllime të ndryshme. *Cookies* mund të jenë të nevojshme në mënyrë që një faqe e internetit të funksionojë si duhet. Për shembull, pa cookies, do të ishte e vështirë të mbahet mend se jeni regjistruar në një faqe interneti ose cilat produkte i keni shtuar në shportën tuaj të blerjeve. Këto cookies quhen cookies funksionale.

Cookies mund të përdoren gjithashtu për të analizuar përdorimin e një faqe interneti, për të regjistruar numrin e vizitorëve ose për të gjetur se si mund të përmirësohet faqja e internetit. Ne nuk do t'i lidhim statistikën e faqes së internetit dhe raportet e tjera me përdoruesit individualë. Këto cookies quhen cookies analitike.

Përveç kësaj, cookies përdoren për mediat shoqërore për të mundësuar integrimin e tyre në faqen e internetit. Kjo bën të mundur që menjëherë të pëlqeni ose të ndani një faqe ose produkt në platformën tuaj të preferuar të mediave shoqërore.

Zbatimi i katërt i rëndësishëm i cookies është reklamimi online. Kjo mundëson reklama të personalizuar që mund të jenë relevante ose me interes për ju, si brenda ashtu dhe jashtë faqes sonë të internetit. Kjo bëhet me ndihmën e cookies për reklamim (të synuar).

Menaxhimi ose ç'aktivizimi i cookies në shfletuesin tuaj

Ju mund të menaxhoni parametrat/konfigurimin tuaj të *cookies* në shfletuesin tuaj. Nëse thjesht i çaktivizoni të gjitha cookies ose të gjitha cookies tona në parametrat e shfletuesit tuaj, disa pjesë ose funksione të faqes (ve) sonë të internetit mund të mos funksionojnë më, pasi nuk mund të përdorim më cookies që kërkohen për funksionimin e duhur të faqes së internetit. Ju mund të gjeni më shumë informacion mbi ç'aktivizimin e cookies ose menaxhimin e konfigurimit/parametrave të cookies të shfletuesit tuaj më poshtë:

- Google Chrome: <https://support.google.com/chrome/answer/95647?hl=en>
- Firefox <https://support.mozilla.org/en-US/kb/enable-and-disable-cookies-website-preferences>
- Internet Explorer: <http://windows.microsoft.com/en-GB/windows-vista/Block-or-allow-cookies>
- Safari: <http://help.apple.com/safari/mac/8.0/#/sfri11471>



4. Me kë i ndajmë të dhënat tuaja personale?

Në përgjithësi, ne nuk do të ndajmë të dhënat tuaja personale me palët jashtë Zonës Ekonomike Evropiane ("EEA"). Megjithatë, ne mund të ndajmë informacionet tuaja me ndërmarrjet e lidhura brenda EEA. Përveç kësaj, është e mundur që *cookies* mund të vendosen nga palët e treta.

Megjithëse ne i ndajmë të dhënat tuaja personale me ofruesit e shërbimeve të TIK, ne e bëjmë këtë vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ne do t'u japim qasje ofruesve të tillë të shërbimeve në të dhënat tuaja personale vetëm pasi të kemi lidhur marrëveshje procesimi me ta, në të cilat ndër të tjera vendosim një detyrim konfidencialiteti dhe i detyrojmë ata që të përpunojnë të dhënat tuaja personale vetëm nën autoritetin tonë.

Përveç kësaj, ne do të lejojmë që palët e treta të kenë qasje në të dhënat tuaja personale vetëm nëse konsiderojmë se kjo kërkohet në bazë të legjislacionit në fuqi ose në bazë të një kërkesë ligjore.

5. Si i sigurojmë të dhënat tuaja personale?

Ne kemi ndërmarrë masat e duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat tuaja personale nga humbja, keqpërdorimi dhe qasja e paautorizuar nga palët e treta. Përveç kësaj, ne i detyrojmë të gjithë ofruesit tanë të TIK që kanë qasje në të dhënat tuaja personale për të ndërmarrë masa të ngjashme dhe të përshtatshme teknike dhe organizative të sigurisë.

6. Cilat janë të drejtat tuaja?

Ju mund të përdorni informacionin kontaktues në fund të deklaratës së privatësisë për të na kontaktuar, nëse ju:

- dëshironi të dini nëse dhe cilat të dhëna personale përpunojmë;
- dëshironi të korrigjoni të dhënat tuaja personale;
- dëshironi të fshini të dhënat tuaja personale;
- dëshironi të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja personale;
- dëshironi të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale;
- dëshironi që ne të transferojmë të dhënat tuaja personale tek ju ose tek një organizatë tjetër

Ne kemi të drejtë të kërkojmë informacion shtesë nga ju për të përcaktuar identitetin tuaj. Ne do t'ju informojmë brenda afatit të duhur për masat që kemi marrë dhe, në çdo rast, brenda një muaji pas marrjes së kërkesës suaj. Nëse është e nevojshme, kjo periudhë mund të zgjatet edhe për dy muaj, edhe për shkak të kompleksitetit apo numrit të kërkesave. Ne do t'ju informojmë për një zgjatje të tillë afati brenda një muaji nga marrja e kërkesës suaj. Ne gjithashtu do të ju sqarojmë arsyet për këtë zgjatje.

Ju keni të drejtë, në çdo kohë, të parashtroni një ankesë pranë autoritetit mbikëqyrës.



7. Ndryshimet

Produktet dhe shërbimet tona i nënshtrohen zhvillimit të vazhdueshëm. Për këtë arsye, ne rezervojmë të drejtën për të ndryshuar ose plotësuar këtë deklaratë të privatësisë kohë pas kohe dhe për të postuar ndonjë version të ndryshuar në faqet tona të internetit.

Ne do të vendosim një njoftim të dukshëm në faqen tonë të deklaratës së privatësisë për t'ju informuar për ndryshimet e rëndësishme në këtë deklaratë të privatësisë. Përveç kësaj, në pjesën e sipërme të këtij njoftimi do të theksojmë se kur është rishikuar deklarata së fundmi. Ne ju rekomandojmë që të lexoni versionin më të fundit në baza të rregullta.

Deklarata e re e privatësisë hyn në fuqi sapo të jetë postuar. Nëse nuk pajtoheni me deklaratën e përshtatur, duhet të bëni ndryshimin e preferencave tuaja ose të shqyrtoni mos-përdorimin e mëtejme të faqeve tona të internetit. Nëse vazhdoni të përdorni ose të hapni shërbimet tona pasi këto ndryshime të kenë hyrë në fuqi, do të konsiderohet se ju pajtoheni me deklaratën e përshtatur të privatësisë.

8. Kontakti

Ju mund të na kontaktoni përmes service@biggreenegg.eu.